



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



UNIVERSIDAD
DE GRANADA

ERASMUS+

Thirrje për bursa trajnimi për stafin akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ me kohë të plotë në kuadër të Programit “Erasmus +” për komponentin KA1 *International Credit Mobility*

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë në bashkëpunim me **Universitetin e Granadës në Spanjë (University of Granada)** në kuadër të Programit “Erasmus+” për komponentin KA1, fton të gjithë stafin me kohë të plotë në UV të aplikojnë për bursë për mobilitet trajnim.

Mobiliteti përfshin:

- Shkëmbimin e stafit akademik e ndihmës akademik për trajnim.
- Kohëzgjatja: 5 + 2 ditë.
- Numri i mobiliteteve: - 1 bursë për staf akademik
- 1 bursë për staf ndihmës akademik
- Periudha e mobilitetit: 15-19 Prill 2024. Programi i përkohshëm dhe detaje të mëtejshme të aktivitetit gjenden në linkun: https://internacional.ugr.es/pages/perfiles/pas/staff-training-week#_doku_th_staff_training_week_international_relations_looking_towards_the_future
- Dieta ditore: 160 Euro.
- Shpenzime udhëtimi: 360 Euro. Shpenzimet e udhëtimit përlllogariten në bazë të largësisë sipas linkut: https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/distance-calculator_en

Kriteret për aplikim për staf akademik:

- Staf akademik me kohë të plotë në UV.
- Njohja e gjuhës angleze minimalisht në nivelin B2.

Kriteret për aplikim për staf ndihmës akademik

- Staf ndihmës akademik me karakter administrativ me kohë të plotë në UV.
- Njohja e gjuhës angleze minimalisht në nivelin B2.

Kriteret e përzgjedhjes:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Stafi do të përzgjidhet në bazë të skemës së miratuar në rregulloren “Për Implementimin e Marrëveshjeve Ndër-institucionale në Kuadër të Programit Erasmus+ KA107 International Credit Mobility”, sipas kriterëve të mëposhtme:

- Arritja akademike. Titulli akademik/ Grada shkencore për stafin akademik.
- Eksperienca në punë për stafin ndihmës akademik/administrativ.
- Kompetenca e gjuhës së huaj.
- Pjesëmarrje në mobilitete. Prioritet do t’u jepet stafit që nuk kanë përfituar më parë nga programi Erasmus+ KA1.

Kritere shtesë:

- Argumentimi i qartë i qëllimit të vizitës, planit të punës në institucionin pritës si një vlerë e shtuar e mobilitetit në kontekstin e modernizimit dhe ndërkombëtarizimit të strategjisë së UV-së.
- Barazia gjinore (aty ku është e mundur, të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formular i aplikimit.
- Kopje e dokumentit identifikues/ pasaportë.
- Dokument që vërteton statusin e të punësuarit pranë UV-së.
- Jetëshkrimi (Curriculum Vitae) në gjuhën angleze.
- Vërtetim nga Rektori / Dekani i Fakultetit tuaj që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.
- Çertifikatë që vërteton njohjen e gjuhës (minimalisht niveli B2). Përfshihet nga ky detyrim personeli akademik i gjuhës angleze.

Dorëzimi i dokumentave të aplikimit kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Elektronikisht (të skanuara në formatin pdf) në adresën international@univlora.edu.al
- Dorazi pranë Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë pranë Rektoratit, Kati i I-rë.

Afati i fundit i aplikimit është 24/01/2024

Procedura e përzgjedhjes:

1. UV ngrë një komision *ad-hoc*, i cili do t’i rendisë kandidatët në bazë të skemës së pikëzimit si dhe kriterëve të thirrjes.
2. Kandidatët fitues do të njoftohen prej SPMJ-së në adresën e tyre të email-it.
3. Kandidatët aplikues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit *ad-hoc* pranë Rektorit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.
4. Në përfundim të afatit të ankimit, SPMJ përcjell listën e stafit të nominuar pranë universitetit pritës.
5. Stafi i përzgjedhur do të duhet të plotësojë një formular aplikimi online nepermjet linkut që do ti jepet prej SPMJ.

Informacion më të detajuar mbi universitetin pritës e gjeni në linkun <https://www.ugr.es/en>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Për më shumë informacion rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni me Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (international@univlora.edu.al).

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ju uron suksese!